VENDIM
Nr. 679, datë 26.10.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI DHE FUQIZIMI I SEGMENTIT TË LINJËS 35 kV TEC/FIER–HOXHARË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit "Rikonstruksioni dhe fuqizimi i segmentit të linjës 35 kV TEC/Fier–Hoxharë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 160 121.49 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e një pikë dyzet e nëntë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, në masën 160 121.49 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e një pikë dyzet e nëntë) lekë, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive, pronë private, të pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi paraqesin dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI DHE FUQIZIMI I SEGMENTIT TË LINJËS 35 kV TEC–FIER–HOXHARE"

Qarku: Fier

Lloji i pasurive të paluajtshme që shpronësohen: Tokë arë

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë								Sip. shpronësimI për shtyllë m^2	Vlera e shpronësimit në lek/m^2	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sasia sip pronës m^2				
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	11	12	13	14
1	21	Mynyr Neim Braka			Zhupan	3934	292/45	Tokë arë	6000	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
2	20	Arben Rapi Tafa			Zhupan	3934	280/332	Tokë arë	4000	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
3	19	Florim Nazmi Mysli dhe Nazmi Hetem Mysli			Zhupan	3934	280/239	Tokë arë	1254	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
4	16	Raif Asllan Hoxha			Drizë	1557	270/67	Tokë arë	2000	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
5	14	Astrit Faik Hoxhaj			Drizë	1557	279/28	Tokë arë	2060	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
6	22	Resul Rexhep Sulejmani			Vadhizë	3691	292/19	Tokë arë	5817	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier.
7	41	Haxhi Zengjel Fasko			Radostinë	3143	81/12	Tokë arë	16075	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
8	49	Hazir Nuri Trakalaçi			Pojan	3015	18/47	Tokë arë	4500	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
9	46	Tasi Sotir Dimo			Pojan	3015	6/1	Tokë arë	3700	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
10	48	Idri Kadri Trakalaçi			Pojan	3015	19/35	Tokë arë	530	31.49	269	**8,470.81**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
11	53	Agim Jonuz Zeqo			Hoxharë	1969	76/11	Tokë arë	4441	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
12	54	Loni Rako Lica			Hoxharë	1969	76/7	Tokë arë	4475	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
13	55	Rexhep Ramiz Berisha			Hoxharë	1969	76/2	Tokë arë	6969	25	269	**6,725.00**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
14	56	Gëzim Hazir Spahia			Hoxharë	1969	39/4	Tokë arë	10494	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
15	60	Sofie Kozi Dima			Fushë	1655	78/1	Tokë arë	25060	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
16	61	Shpresa Hysen Kola / Elona Llambi Kola/Eriselda Llambi Pone			Fushë	1655	77/39	Tokë arë	10000	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
17	62	Pandeli Llazi Llupi			Fushë	1655	77/24	Tokë arë	1670	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
18	63	Arqile Loni Mici			Fushë	1655	87/9	Tokë arë	2214	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
19	65	Sotiraq Lipi Zarka			Fushë	1655	88/19	Tokë arë	1500	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
20	66	Gjergji Gori Llupi			Fushë	1655	92/1	Tokë arë	6300	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
21	67	Arqile Kristo Kerri			Fushë	1655	92/8	Tokë arë	3168	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
22	68	Teli Vasil Hudhra			Fushë	1655	92/13	Tokë arë	7770	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
23	70	Thoma Kozma Nure			Fushë	1655	98/5	Tokë arë	9350	35.61	269	**9,579.09**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
24	73	Andon Kostandin Spiro			Fushë	1655	47/9	Tokë arë	3500	22.62	269	**6,084.78**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
25	64	Kristaq Toma Llupi			Fushë	1655	88/5	Tokë arë	2000	28.09	269	**7,566.21**	Sipas konfirmimit zyrtar të ASHK Fier
VLERA TOTALE										**595.21**		**160,121.49**	

Mbyllet me nr. rendor 25.